Proteina e rrezikshme *spike* (spajk) në vaksinat ARNm

Përgaditun prej Z.H.

Prof. Dr. Bryam Bridle

Nji kërkim i ri "tmerrues" zbulon papritun hymjen e proteinës *spike* në gjak. Kjo proteinë që gjindet në vaksinat e tipit ARNm ka lidhje me pllakat e gjakut, me damtime të zemrës dhe të trunit, dhe paraqet rrezik potencial për fmijtë në gji dhe fertilitetin.

Nji studim i ri i nji grupi shkenctarësh ndërkombtarë, të drejtuem prej specialistit kanadez në imunologji virale, Prof. Dr. Bryam Bridle, i Universitetit Guelph të Ontarios, ka nxjerrë rezultate befasuese mbi rrezikshmëninë e proteinës *spike*, që gjindet në vaksinat e tipit ARNm, kryesisht të Pfeizer dhe Moderna.

"Vetë proteina *spike* (spajk) asht toksike dhe e rrezikshme për njirin", ka

deklarue Prof. Bridle.

"Deri më sod, nuk kena mendue kurrë se proteinat *spike* mund të ishin toksike. Vaksinat ARNm që janë testue për herë të parë mbi kafshë, rezultatet e të cilave nuk janë ba asnjiherë publike, na diftojnë se nanogrimcat (nanoparticules) e ARNm nuk qëndrojnë në vendin muskular (shpatull, krah) të injektimit, siç mendohej dhe reklamohej prej prodhuesve të saj, por futen në gjak dhe shkojnë në organe, kajherë në përqendrime dramatike, prej ku kto grimca transferohen nga qeliza në qelizë dhe absorbohen simbas nji proçesi t'vazhdueshëm", shton Bridle.

Shkenctarët e grupit të prof. Bridle kanë zbulue se proteina *spike* e vaksinës asht nji toksinë që krijon damtime në sistemin kardo-vaskular, përfshi ktu hemorragji. Për ma tepër, kjo proteinë mundet me kalue përtej barrierës hemato-cefale për me shkaktue damtime në tru. Në praktikë, mbas kryemjes së nji terapie gjenike (e quejtun publikisht "vaksinim") me vaskinen e Moderna-s te 13 të rijë, asht vërejt se te 11 prej tyne proteina *spike* ka hy në gjak. Prej aty, kjo proteinë mundet me u bashkue me receptorët sanguinë dhe mundet me shkaktue koagulim, pllaka gjaku, e probleme neurologjike. Kjo shpjegon efektet dytsore të randa që praktiksht janë obzervue mbas injektimit të ktyne vaksinave (trombozë, pllaka gjaku, etj.).

Kërkimet e masipërme e kanë shty Dr. Bridle me deklarue :

"Kena gabue randë. Vetë proteina *spike* asht toksike dhe e rrezikshme për njirin. Ajo biles transmetohet edhe te fmijtë, nëpërmjet qumshtit të nanës."

Në përgjigje të ktij kërkimi të profesorit kanadez dhe grupit të tij, fituesi i çmimit Nobel në mjeksi, Prof. Luc Montagnier, ka deklarue :

"Në emën të principit të sigurisë, duhen ndalue menjiherë vaksinimet me proteinen *spike*."

Nji studim sekret (confidencial) tek mijtë, kurrë i bamë publik, i kryem prej vetë Pfizer, nji prej prodhuesve të vaksinave ARNm, zbulon kjart përhapjen e proteinës *spike* në organe dhe inde. Kto konkluzione të vetë Pfizer-it nuk janë nji suprizë, por pasojat janë të tmerrshme, thekson Stephanie Seneff, drejtuese kërkimi në "Massachusetts Institute of Technology".

Simbas ktij studimi sekret të Pfizer, që s'parit asht publikue prej nji agjencije japoneze, e cila ia ka shpërnda mandej grupi kërkues të Prof. Bidle, me kërkesen e ktyne t'fundit, e që tashti mundet me u shkarkue falas në internet, po bie disa shembuj të përqëndrimit të proteinës *spike* në organe mbas vaksinimit të mijve. Për ma shumë, po bie dy tabela me të dhanat komplete të përqendrimeve në pjesë të ndryshme të trupit (shif dy faqet e fundit të ktij shkrimi) :

Në gjendrat e adrenalinës, mbas 25 min, prej momentit të injeksionit, përqendrimi i proteinës *spike* ishte 0.271; mbas 48 orësh, përqendrimi ishte 18.2 ; në palcen e kocit (femur), mbas 25 min. përqëndrimi ishte 0.479, kurse mbas 48 orësh, përqëndrimi shkoi në 3.77 ; në melqi, mbas 25 min. përqendrimi ishte 0.737, kurse mbas 48 orësh, përqendrimi ishte 24.3 ; në vezore, mbas 25 min. përqendrimi ishte 0.104, kurse mbas 48 orësh, përqendrimi ishte 12.3 ; në shpretkë, mbas 25 min. përqendrimi ishte 0.334, kurse mbas 48 orësh, përqendrimi ishte 23.4.

Institucioni qeveritar amerikan që kontrollon ushqimet dhe ilaçet, FDA (Food and Drug Administration), asnjiherë nuk e ka aprovue zyrtarisht vaksinimin me vaksinat e tipit ARNm, të Pfizer, Moderna, Johnson&Johnson, etj. Përkundrazi, J.Patrick Whelan, reumatolog pediatër, kishte paralajmrue kohë ma parë nji komitet kshillues të FDA, mbi rrezikun e mundshëm të proteinës *spike* për me shkaktue damtime të zgjatuna ose të përhershme në rrjetin mikrovaskular, në melqi, në zemër dhe në tru.

Simbas VAERS, sistemit të lajmrimit të pasojave të padishirueshme të vaksinave në USA, deri me datë 21 Maj 2021, janë rregjistrue 4000 vdekje dhe 15000 shtruemje n'spital, si pasojë e vaksinimit kundër covidit. Mekense ky asht nji sistem pasif grumbullimit të dhanash, infot e tija janë me shumë gjasa veç maja e ajsbergut : nji studim nga "Harvard Pilgrim Healthcare", raporton se ma pak se 1 % e efekteve dytsore t'padishirueshme raportohen faktikisht prej mjekve.

Si përmenda ma nalt, prof. Bridle ndër të tjera thekson se zbulimi i rrezikut të proteinës *spike* ka pasoja edhe te fmijët që ushqehen me qumshtin e nanës, si pasojë e rrezikut të marrjes së ktyne proteinave *spike* me anen e qumshtit. Na kena prova të problemeve të koagulimit në traktin gastro-intestinal, thotë shkenctari kanadez, të fmijve të ushqyem me gji. Në fakt, VAERS raporton (ID 1166062) mbi nji nanë që me 17 Mars 2021 kishte

marrë dozen e dytë të vaksinës Pfizer. Nji ditë ma vonë, me 18 Mars 2021, fmija i saj 5 muejsh që ushqehej me gji shfaq skuqje në trup, dhe mbas 24 orësh nuk qetsohet mâ, refuzon me pi dhe shfaq ethe. Mbas nji analize gjaku u vërejt nji nivel i naltë i enzimave të melqisë. Fmija u shtrue në spital, por gjendja e tij u përkeqsue deri sa ndrroi jetë. Diagnoza ishte "Thrombotic thrombocytopenic purpura", nji smundje e rrallë e gjakut që karakterizohet prej formimit të pllakzave të gjakut në tanë trupin. Nuk njihen alergji. Fmija nuk i asht ekspozue personave të tjerë, përveç qumshtit të nanës, e cila ishte vaksinue nji ditë përpara.

Nga ana tjetër, përqëndrimi i naltë i proteinës *spike* në organet riprodhuese të të dyja gjinive krijon shqetsim serioz. "A dishirojmë me i ba sterilë fmijtë tanë ?", pyet prof. Bridle, i cili përmend gjithashtu edhe nji fushatë denigruese personale t'fillueme kohët e fundit kundër rezultateve të kërkimeve të grupit të tij, fushatë që përfshin edhe hapjen e nji faqeje shpifse interneti, nën emnin e tij. "Në kto momente, nji universitar nuk mundet me iu përgjigjë me ndershmëni dhe referenca shkencore pyetjeve legjitime të njerzve, pa u shpifë dhe kërcënue. Sidokjoft, nuk asht në natyren teme me ia mshehë publikut faktet shkencore", thotë Prof. Bridle.

Pfizer, Moderna dhe Johnson & Johnson nuk janë prononcue mbi shqetsimet e ngrituna prej studimit të grupit shkencor të Prof. Bridle. Pfizer, n'veçanti, nuk ia asht përgjigjë pyetjes se qysh kur kjo kompani ishte në dijeni të studimit të publikuem prej agjensisë japoneze, mbi përqendrimin e naltë të proteinës *spike* në organe dhe inde të trupit.

(Njof personalisht nji rast konkret të nji punojsi të Pfizer që refuzon me ba vaksinen e kompanisë ku ajo punon, por thotë se e ka të ndalueme me komentue kyt zgjedhje të saj.)

Prof. Bryam Bridle, vetëm në vitin 2020, ka marrë prej Qeverisë kanadeze nji subvencion prej 200,000 dollarësh për kërkime mbi vaksinat covid.

Laboratori shkencor-kërkimor Bridle ka kenë dhe asht i financuem edhe prej organizateve të maposhtme :

- Instituti kanadez i kërkimit mbi shëndetin (*Canadian Institute of Health Research*)
- Kshilli kanadez i kërkimit në shkenca natyrore dhe ingjinierike (*Natural Sciences and Engineering Research Council of Canada - NSERC*)

- Instituti i kërkimeve Terry Fox (*Terry Fox Research Institute*)
- Shoqnija kanadeze e kërkimeve mbi kancerin (*Canadian Cancer Society*)
- Fondacioni kanadez mbi kancerin e gjinit (*Canadian Breast Cancer Foundation*)
- Fondi i kërkimeve imergjente të Covid-19 i Ontarios (*Ontario COVID-19 Rapid Research Fund*)
- Universiteti Guelph, Ontario
- Kolegji veterinar i Ontarios
- Fondi kanadez për novacion (*Canada Foundation for Innovation*)
- Fondi kanadez i kërkimit të Ministrisë së kërkimit dhe novacionit

Referenca :

- Shkrimi bazohet mbi nji artikull të 2 Qershorit 2021, publikue te revista e pamvarun franceze "France soir", dhe te nji shkrim i 31 Majit 2021, publikue te "Life Site News". Për info të saktë mbi referencat e përmenduna në shkrimin e masipërm, luteni me m'kontaktue me mesazh privat.

2.6.5.5B. PHARMACOKINETICS: ORGAN DISTRIBUTION CONTINUED

Test Article: [3H]-Labelled LNP-mRNA formulation containing ALC-0315 and ALC-0159

Report Number: 185350

Species (Strain):	Rat (Wistar Han)
Sex/Number of Animals:	Male and female/3 animals/sex/timepoint (21 animals/sex total for the 50 µg dose)
Feeding Condition:	Fed adlibitum
Method of Administration:	Intramuscular injection
Please:	50 µg [3H]-08-A01-C0 (lot # NC-0552-1)
Number of Doses:	1
Detection:	Radioactivity quantitation using liquid scintillation counting
Sampling Time (hour):	0.25, 1, 2, 4, 8, 24, and 48 hours post-injection

Sample	Mean total lipid concentration (µg lipid equivalent/g (or mL) (males and females combined)							% of administered dose (males and females combined)						
	0.25 h	1 h	2 h	4 h	8 h	24 h	48 h	0.25 h	1 h	2 h	4 h	8 h	24 h	48 h
Adipose tissue	0.057	0.100	0.126	0.128	0.093	0.084	0.181	-	-	-	-	-	-	-
Adrenal glands	0.271	1.48	2.72	2.89	6.80	13.8	18.2	0.001	0.007	0.010	0.015	0.035	0.066	0.106
Bladder	0.041	0.130	0.146	0.167	0.148	0.247	0.365	0.000	0.001	0.001	0.001	0.001	0.002	0.002
Bone (femur)	0.091	0.195	0.266	0.276	0.340	0.342	0.687	-	-	-	-	-	-	-
Bone marrow (femur)	0.479	0.960	1.24	1.24	1.84	2.49	3.77	-	-	-	-	-	-	-
Brain	0.045	0.100	0.138	0.115	0.073	0.069	0.068	0.007	0.013	0.020	0.016	0.011	0.010	0.009
Eyes	0.010	0.035	0.052	0.067	0.059	0.091	0.112	0.000	0.001	0.001	0.002	0.002	0.002	0.003
Heart	0.282	1.03	1.40	0.987	0.790	0.451	0.546	0.018	0.056	0.084	0.060	0.042	0.027	0.030
Injection site	128	394	311	338	213	195	165	19.9	52.6	31.6	28.4	21.9	29.1	24.6
Kidneys	0.391	1.16	2.05	0.924	0.590	0.426	0.425	0.050	0.124	0.211	0.109	0.075	0.054	0.057
Large intestine	0.013	0.048	0.093	0.287	0.649	1.10	1.34	0.008	0.025	0.065	0.192	0.405	0.692	0.762
Liver	0.737	4.63	11.0	16.5	26.5	19.2	24.3	0.602	2.87	7.33	11.9	18.1	15.4	16.2
Lung	0.492	1.21	1.83	1.50	1.15	1.04	1.09	0.052	0.101	0.178	0.169	0.122	0.101	0.101

2.6.5.5B. PHARMACOKINETICS: ORGAN DISTRIBUTION CONTINUED

Test Article: [3H]-Labelled LNP-mRNA formulation containing ALC-0315 and ALC-0159 Report Number: 185350

Sample	Total Lipid concentration (µg lipid equivalent/g [or mL]) (males and females combined)							% of Administered Dose (males and females combined)						
	0.25 h	1 h	2 h	4 h	8 h	24 h	48 h	0.25 h	1 h	2 h	4 h	8 h	24 h	48 h
Lymph (mandibular)	0.064	0.189	0.290	0.408	0.534	0.554	0.727	-	-	-	-	-	-	-
Lymph node (mesenteric)	0.050	0.146	0.530	0.489	0.689	0.985	1.37	-	-	-	-	-	-	-
Muscle	0.021	0.061	0.084	0.103	0.096	0.095	0.192	-	-	-	-	-	-	-
Ovaries (females)	0.104	1.34	1.64	2.34	3.09	5.24	12.3	0.001	0.009	0.008	0.016	0.025	0.037	0.095
Pancreas	0.081	0.207	0.414	0.380	0.294	0.358	0.599	0.003	0.007	0.014	0.015	0.015	0.011	0.019
Pituitary gland	0.339	0.645	0.868	0.854	0.405	0.478	0.694	0.000	0.001	0.001	0.001	0.000	0.000	0.001
Prostate (males)	0.061	0.091	0.128	0.157	0.150	0.183	0.170	0.001	0.001	0.002	0.003	0.003	0.004	0.003
Salivary glands	0.084	0.193	0.255	0.220	0.135	0.170	0.264	0.003	0.007	0.008	0.008	0.005	0.006	0.009
Skin	0.013	0.208	0.159	0.145	0.119	0.157	0.253	-	-	-	-	-	-	-
Small intestine	0.030	0.221	0.476	0.879	1.28	1.30	1.47	0.024	0.130	0.319	0.543	0.776	0.906	0.835
Spinal cord	0.043	0.097	0.169	0.250	0.106	0.085	0.112	0.001	0.002	0.002	0.003	0.001	0.001	0.001
Spleen	0.334	2.47	7.73	10.3	22.1	20.1	23.4	0.013	0.093	0.325	0.385	0.982	0.821	1.03
Stomach	0.017	0.065	0.115	0.144	0.268	0.152	0.215	0.006	0.019	0.034	0.030	0.040	0.037	0.039
Tests (Males)	0.031	0.042	0.079	0.129	0.146	0.304	0.320	0.007	0.010	0.017	0.030	0.034	0.074	0.074
Thymus	0.088	0.243	0.340	0.335	0.196	0.207	0.331	0.004	0.007	0.010	0.012	0.008	0.007	0.008
Thyroid	0.155	0.536	0.842	0.851	0.544	0.578	1.00	0.000	0.001	0.001	0.001	0.001	0.001	0.001
Uterus (females)	0.043	0.203	0.305	0.140	0.287	0.289	0.456	0.002	0.011	0.015	0.008	0.016	0.018	0.022
Whole blood	1.97	4.37	5.40	3.05	1.31	0.909	0.420	-	-	-	-	-	-	-
Plasma	3.97	8.13	8.90	6.50	2.36	1.78	0.805	-	-	-	-	-	-	-
Blood: plasma ratio	0.815	0.515	0.550	0.510	0.555	0.530	0.540	-	-	-	-	-	-	-

2.6.5.5B. PHARMACOKINETICS: ORGAN DISTRIBUTION CONTINUED

Test Article: [3H]-Labelled LNP-mRNA formulation containing ALC-0315 and ALC-0159 Report Number: 185350

-- = Not applicable, partial tissue taken; [3H]-08-A01-C0 = An aqueous dispersion of LNPs, including ALC-0315, ALC-0159, distearoylphosphatidylcholine, cholesterol, mRNA encoding luciferase and trace amounts of radiolabeled [Cholesteryl-1,2-3H(N)]-Cholesteryl Hexadecyl Ether, a nonexchangeable, non-metabolizable lipid marker used to monitor the disposition of the LNPs; ALC-0159 = 2-[(polyethylene glycol)-2000]-N,N--ditetradecylacetamide), a proprietary polyethylene glycol-lipid included as an excipient in the LNP formulation used in BNT162b2; ALC-0315 = (4--hydroxybutyl)azanediyl)bis(hexane-6,1-diyl)bis(2-hexyldecanoate), a proprietary aminolipid included as an excipient in the LNP formulation used in BNT162b2; LNP = Lipid nanoparticle; mRNA = messenger RNA.
a. The mean male and female blood:plasma values were first calculated separately and this value represents the mean of the two values.